

# BURIMET *TJERA* TË SË DREJTËS NDËRKOMBËTARE DHE HIERARKIA E NORMAVE NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

## *Qerim Qerimi*

### A. Burimet jo-tradicionale

#### 1. “Ligji i butë”

I ashtuquajturi “ligji i butë” ose “e drejta e butë” është një temë thelbësisht kundërthënëse në praktikën dhe diskursin ligjor ndërkombëtar. Disa juristë kanë kundërshtuar aq të madhe sa që refuzojnë t’i referohen kësaj shprehjeje, veçanërisht në lidhje me burimet.<sup>1</sup> Sidoqoftë, realiteti në sistemin ndërkombëtar është se shpesh nuk është e lehtë ose e mundur që të sigurohet pajtimi i gjerë ose i nevojshëm për rregulla të reja, qoftë kontraktuale apo zakonore. Për këtë arsye, janë përdorur gjithnjë e më shumë instrumente alternative, veçanërisht për çështjet mjedisore, ekonomike dhe të drejtat e njeriut, në formën e deklaratave të parimeve, kodeve të praktikës, rekomandimeve, rezolutave, udhëzuesve, standardeve, shpesh brenda kontekstit të marrëveshjeve “kornizë” apo “ombrellë”, të cilat nuk del të jenë të përfshira në listën e burimeve ligjore të nenit 38(1) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Këto instrumente qartazi nuk paraqesin “ligj” apo “të drejtë” në kuptimin e dispozitës së nenit 38(1) të Statutit ose në kuptimin e krijimit të të drejtave dhe detyrimeve. Duhet vënë re, megjithatë, se karakteristikë e tyre është negociimi i kujdesshëm. Pra, shpesh janë deklarata të hartuara me kujdes, të cilat, pavarësisht formës jo-detyruese ose jo-kontraktuale, në shumë raste kanë rëndësi normative. Për shembull, mund të ofrojnë dëshmi të një *opinio juris*-i, ose mund të shërbejnë si udhëzues për interpretimin ose aplikimin e traktateve, apo mund të shërbejnë edhe si standarde të dakorduara për zbatimin e dispozitave më të përgjithshme të traktateve apo rregullave të së drejtës zakonore.<sup>2</sup>

Ligjërja në fushën e të drejtës ndërkombëtare, njësoj si në shumë fusha të tjera, sot përfshinë një numër të madh të rezolutave dhe deklaratave të Kombeve të Bashkuara. Rëndësia e këtyre instrumenteve ose e parimeve që ato shpallin është se, ato autorizojnë, qoftë edhe nëse nuk detyrojnë, shtetet të veprojnë mbi bazën e parimeve përkatëse; dhe efektet e tyre ligjëbërëse janë të rëndësishme, ndonëse ato kanë shpesh nevojë për zhvillim apo saktësim të mëtejshëm përmes traktateve ose praktikës shtetërore.<sup>3</sup>

<sup>1</sup> Për shembull, Brownlie në librin e tij “Parimet e të Drejtës Ndërkombëtare Publike” [PRINCIPLES OF PUBLIC INTERNATIONAL LAW] nuk e përdor këtë shprehje as në kapitullin për burimet dhe as në *indeksin* e fjalëve.

<sup>2</sup> *Shih* Alan Boyle, *Some Reflections on the Relationship of Treaties and Soft Law*, 48 INTERNATIONAL AND COMPARATIVE LAW QUARTERLY (1999), fq. 901.

<sup>3</sup> *Shih përgjithësisht* IAN BROWNLIE, PRINCIPLES OF PUBLIC INTERNATIONAL LAW, *supra* note 40, 14. *Shih po ashtu* Yves van der Mensbrugge, *Legal Status of International North Sea Conference Declarations*, 5 INTERNATIONAL JOURNAL OF ESTUARINE AND CASUAL LAW 15-22 (1990).

Krahas diskutimit për instrumentet e të ashtuquajturës “e drejtë e butë,” është veçanërisht me vlerë të analizohet statusi ligjor i vendimeve të organeve të Kombeve të Bashkuara.

## 2. Vendimet e organizatave dhe/ose institucioneve ndërkombëtare

Ndonëse nuk mund të gjenden në nenin 38 të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, deklaratat dhe rezolutat e Kombeve të Bashkuara, të agjencive të specializuara, dhe të organizatave të tjera ndër-qeveritare janë cituar ose përdorur shpesh si “dëshmi” për përcaktimin e rregullave të së drejtës ndërkombëtare. Në fakt, disa rezoluta të Asamblesë së Përgjithshme, siç është rasti me Deklaratën e Parimeve të së Drejtës Ndërkombëtare Lidhur me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin Ndërmjet Shteteve në Pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, sot paraqesin zakon ndërkombëtar.<sup>4</sup> Një status të këtillë sot konsiderohet se e ka arritur edhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, ose e pakta, disa nga të drejtat e përmbajtura në këtë Deklaratë.

Një kuptim më i qartë dhe më i plotë i karakterit ligjor të vendimeve ose rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme kërkon leximin e dispozitave përkatëse të instrumentit që i jep autorizime ose pushtet për të vepruar këtij organi, e që është Karta e Kombeve të Bashkuara.

Neni përkatës 10 i Kartës lexon: “Asambleja e Përgjithshme mund të marrë në shqyrtim të gjitha çështjet që bien brenda kuadrit të Kartës ose që kanë të bëjnë me të drejtat e njërës prej organeve të parashikuara në këtë Kartë, dhe me kusht respektimin e nenit 12, ajo mund të bëjë rekomandimet e saj në lidhje me këto çështje, drejtuar anëtarëve të Kombeve të Bashkuara ose Këshillit të Sigurimit ose të dyve bashkë.”<sup>5</sup> Ndërkaq, paragrafi 1 i nenit 11 lexon: “Asambleja e Përgjithshme mund të shqyrtojë të gjitha parimet e përgjithshme të bashkëpunimit për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, përfshirë parimet që qeverisin çarmatosjes dhe rregullimin e armatimit, dhe mund t’u bëjë rekomandime në lidhje me këto parime anëtarëve ose Këshillit të Sigurimit ose të dyve.”<sup>6</sup> Dhe paragrafi 2 i të njëjtit nen: “Asambleja e Përgjithshme mund të shqyrtojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, që i parashtrihen asaj nga çdo anëtar i Kombeve të Bashkuara ose nga Këshilli i Sigurimit ose nga një shtet jo-anëtar i Kombeve të Bashkuara sipas nenit 35, paragrafi 2, dhe përveç siç parashihet në nenin 12, mund t’u bëjë rekomandime në lidhje me këto çështje shteteve të prekura ose Këshillit të Sigurimit ose të dyve.”<sup>7</sup> Tutje, paragrafi 1 i nenit 13 përmban: “(1) Asambleja e Përgjithshme inicicion procese hetimore dhe bën rekomandime ...”<sup>8</sup> ose neni 14: “...Asambleja e Përgjithshme mund të rekomandojë ...”<sup>9</sup>

---

<sup>4</sup> *Shih Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory*, 2004 I.C.J. Reports 136. *Shih* po ashtu mendimin e fundit këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në rastin e *Pajtuësshmërisë me të Drejtën Ndërkombëtare të Deklaratës së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën [Accordance with International Law of the Unilateral Declaration of Independence in Respect of Kosovo, Advisory Opinion, I.C.J. Reports 2010]* para. 80.

<sup>5</sup> Karta e Kombeve të Bashkuara, Can. T.S. 1945 No. 76; [1976] YRBK. U.N. 1043; 59 Stat. 1031, T.S. 993 (*e nënshkruar* në San Francisco më 26 qershor 1945; *ka hyrë në fuqi* më 24 tetor 1945), neni 10.

<sup>6</sup> *Id.* neni 11(1).

<sup>7</sup> *Id.* neni 11(2).

<sup>8</sup> *Id.* neni 13(1).

<sup>9</sup> *Id.* neni 14.

Në të gjitha dispozitat që flasin për autorizimet ose pushtetet e Asamblesë së Përgjithshme, flitet për “rekomandime.” Ky është në fakt edhe cilësimi tipik ligjor që u bëhet vendimeve ose rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme.

Ndonëse ligjërishjt jo-detyruese, vlera normative e rezolutave të Asamblesë së Përgjithshme megjithatë nuk kufizohet vetëm brenda funksionit të rekomandimit. Vlera e tyre mund të manifestohet edhe në dy drejtime të tjera kryesore: Së pari, mund të fitojnë statusin e zakonit ndërkombëtar, si në rastin e Deklaratës më sipër, për Parimet e të Drejtës Ndërkombëtare Lidhur me Marrëdhëniet Miqësore dhe Bashkëpunimin Ndërmjet Shteteve; dhe së dyti dhe më së shpeshti, mund të shërbejnë si mjet për përcaktimin e ekzistimit të një rregulli ose për shfaqjen apo praninë e *opinio juris*. Siç është diskutuar më lartë, në mendimin vetë këshillëdhënës për *ligjshmërinë e kërcënimit ose përdorimit të armëve bërthamore*, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka vërejtur se, rezolutat e Asamblesë së Përgjithshme, edhe nëse nuk janë detyruese, mund të kenë herë pas here vlerë normative.<sup>10</sup> Kjo vlerë normative manifestohet në atë që këto rezoluta mund të ofrojnë në raste të caktuara dëshmi të rëndësishme për përcaktimin e ekzistencës së një rregulli ligjor ose shfaqjes së një *opinio juris*.<sup>11</sup>

Një dimension tjetër, i veçantë, i kësaj teme janë rezolutat e Këshillit të Sigurimit. Brenda kornizës ligjore të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Këshilli i Sigurimit mund të miratojë rezoluta që krijojnë detyrime nën të drejtën ndërkombëtare, veçanërisht mbi bazën e neneve 24, 25 dhe kapitullit VII të Kartës. Kjo është konfirmuar në mendimin e fundit këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë në lidhje me ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës në kontekst të rezolutës 1244 (1999), e cila është miratuar shprehimisht mbi bazën e Kapitullit VII të Kartës dhe, për rrjedhojë, është vlerësuar nga Gjykata se, qartazi krijon detyrime ligjore ndërkombëtare.<sup>12</sup> Në këtë mënyrë, Gjykata e trajton rezolutën 1244 si pjesë të ligjit të aplikueshëm për vlerësimin e ligjshmërisë së Deklaratës së Pavarësisë.<sup>13</sup> Gjykata ka pasur rastin që të interpretojë dhe aplikojë rezoluta të ngjashme të Këshillit edhe në një numër rastesh të tjera dhe i ka trajtuar ato si pjesë të kornizës së detyrimeve ligjore nën të drejtën ndërkombëtare.<sup>14</sup>

Ligjërishjt, rezolutat e Këshillit mbështeten në Kartën e Kombeve të Bashkuara. Në kuptimin e nenit 38(1)(a) të Statutit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, Karta bie brenda kategorisë së konventave ndërkombëtare, dhe për pasojë, rezolutat e Këshillit janë cilësuar edhe si “e drejtë dytësore kontraktuale (ose e Kartës)”<sup>15</sup>. E pakta në këtë kuptim, dhe duke u nisur nga fakti se, Gjykata ka aplikuar në vazhdimësi rezolutat e Këshillit pa ndonjë vështirësi ose referencë te

<sup>10</sup> *Shih Legality of the Threat or Use of Nuclear Weapons*.

<sup>11</sup> *Id.*

<sup>12</sup> *Shih* rastin e *Pajtueshmërisë me të Drejtën Ndërkombëtare të Deklaratës së Njëanshme të Pavarësisë në lidhje me Kosovën*, *supra* note 4, para. 85.

<sup>13</sup> *Id.*

<sup>14</sup> *Shih, p.sh., Legal Consequences for States of the Continued Presence of South Africa in Namibia (South West Africa) notwithstanding Security Council Resolution 276 (1970), Advisory Opinion, I.C.J. Reports 1971, p. 16*; *Questions of Interpretation and Application of the 1971 Montreal Convention arising from the Aerial Incident at Lockerbie (Libyan Arab Jamahiriya v. United Kingdom), Provisional Measures, Order of 14 April 1992, I.C.J. Reports 1992, para. 39-41*; *Questions of Interpretation and Application of the 1971 Montreal Convention arising from the Aerial Incident at Lockerbie (Libyan Arab Jamahiriya v. United States of America), Provisional Measures, Order of 14 April 1992, I.C.J. Reports 1992, para. 42-44*.

<sup>15</sup> Stefan Talmon, *The Security Council as World Legislature*, 99 AMERICAN JOURNAL OF INTERNATIONAL LAW 175, 179 (2005).

mungesa e plotësisë së nenit 38, është sugjeruar se, burimi i rezolutave detyruese të Këshillit, qoftë të karakterit të përgjithshëm ose të veçantë, duhet parë brenda shtrirjes së burimeve tradicionale të së drejtës ndërkombëtare;<sup>16</sup> dhe se karakteri i këtyre rezolutave do të ndryshonte vetëm po qe se Këshilli shprehimisht do të kishte vepruar jashtë kornizës së Kartës së Kombeve të Bashkuara, ta zëmë, duke vendosur detyrime për shtetet jo-anëtare të Kombeve të Bashkuara.<sup>17</sup>

### 3. Veprimet e njëanshme (ose *aktet unilaterale*) si burim i të drejtës ndërkombëtare

Në *rastet e testeve bërthamore* (Australia kundër Francës dhe Zelanda e Re kundër Francës), Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka pasur rastin të deklarohet lidhur me statusin dhe efektet e deklaratave të njëanshme në planin ndërkombëtar. Në kontekst të shqyrtimit dhe qartësimin të asaj nëse deklaratat e bëra nga autoritetet e Francës kënaqin kërkesat e Australisë dhe Zelandës së Re se nuk do të zhvillohen testet të tjera bërthamore atmosferike në Paqësorin Jugor, Gjykata ka thënë:

*“Është mirë e pranuar se deklaratat e bëra në formë të veprimeve të njëanshme, lidhur me situata ligjore ose faktike, mund të kenë efektin e krijimit të detyrimeve ligjore. Deklaratat e këtij lloji mund të jenë, dhe shpesh janë, shumë specifike. Kur është qëllimi i shtetit që e bën deklaratën që ai të duhet të detyrohet sipas termave të saj, ai qëllim i jep deklaratës karakterin e një ndërmarrjeje ligjore, dhe shteti këtu e tutje ligjërisht kërkohet të ndjekë një mënyrë sjelljeje në pajtim me deklaratën. Një ndërmarrje e këtij lloji, nëse bëhet publikisht, dhe me qëllimin për t’u detyruar, qoftë edhe nëse nuk është bërë në kontekst të negociatave ndërkombëtare, është detyruese. Në këto rrethana, asgjë e natyrës së një *quid pro quo*, as dhe ndonjë pranim i mëpastajmë i deklaratës, dhe madje as dhe ndonjë përgjigje apo reagim nga shtetet e tjera, nuk kërkohet që deklarata të prodhojë efekte [hyjë në fuqi], pasi një kërkesë e këtillë do të ishte në kundërshtim me natyrën strikte të njëanshme të aktit juridik me të cilin është bërë deklarimi nga shteti.”<sup>18</sup>*

Në këtë mënyrë, Gjykata ka hequr çdo dyshim lidhur me efektet ligjërisht detyruese në planin ndërkombëtar të deklaratave të bëra në formën e veprimeve të njëanshme. Sidoqoftë, ajo ka vendosur dy kushte që duhen plotësuar në mënyrë që një veprim i njëanshëm të prodhojë efekte ligjërisht detyruese. Deklarata duhet (1) të bëhet publikisht, dhe (2) me qëllimin për t’u detyruar nga një ndërmarrje e këtillë e njëanshme.

#### B. Rregullat “tjera” të së Drejtës Ndërkombëtare

Është e natyrshme që në proces të zhvillimit të sistemit ligjor ndërkombëtar, kanë lindur parime dhe rregulla, të cilat paraqesin burime të detyrimeve ligjore ndërkombëtare. Roli i tyre është qenësor, jo vetëm në zhvillimin e mëtejshëm të fushës së të drejtës ndërkombëtare, por edhe në

<sup>16</sup> *Id.* fq. 179. Por, shih Krzysztof Skubiszewski, *International Legislation*, në 2 *ENCYCLOPEDIA OF PUBLIC INTERNATIONAL LAW* 1255, 1261 (Rudolf Bernhardt ed., 1995), për një perspektivë tjetër. Skubiszewski i konsideron veprimet ligjëbërëse të organizatave ndërkombëtare si burim i ri i të drejtës, i veçantë prej traktateve.

<sup>17</sup> *Shih* Stefan Talmon, *supra* note 77, fq. 179.

<sup>18</sup> *Shih Nuclear Tests (Australia v. France)*, fq. 253, para. 43; *Nuclear Tests (New Zealand v. France)*, fq. 457, para. 46.

vendosjen e standardeve të qëndrueshme që ofrojnë sigurinë e nevojshme juridike në sistemin ndërkombëtar.

## 1. Normat *jus cogens*

Normat *jus cogens* janë norma të së drejtës ndërkombëtare që janë të pranuar nga bashkësia ndërkombëtare e shteteve si superiore (ose imperative), dhe që nuk lejojnë përjashtim. Këto norma mbizotërojnë dhe i bëjnë të pavlefshme marrëveshjet ndërkombëtare dhe rregullat e tjera të së drejtës ndërkombëtare që janë në kundërshtim me to, dhe janë subjekt i modifikimit vetëm nga një normë pasuese e të drejtës së përgjithshme ndërkombëtare që ka karakterin e njëjtë. Ky parim është kodifikuar në nenin 53 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve.<sup>19</sup>

Ndonëse ka pranueshmëri të gjerë për normat *jus cogens*, janë norma që identifikohen me vështirësi dhe që zhvillohen me kalimin e kohës përmes konsensusit të përgjithshëm të bashkësisë ndërkombëtare. Prandaj, nuk ka pajtueshmëri të plotë për atë se çfarë bën pjesë në grupin e normave *jus cogens*. Ajo për çfarë duket se ka një pajtueshmëri të përgjithshme është lista si në vijim: ndalimi i gjenocidit; ndalimi i torturës; ndalimi i skllavërisë dhe tregtisë me skllavër; ndalimi i agresionit; ndalimi i piraterisë; ndalimi i diskriminimit racor; mohimi i të drejtës për vetëvendosje. Cenimi ose shkelja e këtyre normave ka për pasojë detyrimet e ashtuquajtura *erga omnes*.<sup>20</sup>

Sipas Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, “detyrimet e këtilla ... në të drejtën bashkëkohore ndërkombëtare rrjedhin nga ndalimi i akteve të agresionit dhe gjenocidit, por po ashtu edhe nga parimet dhe rregullat që kanë të bëjnë me të drejtat elementare të njeriut, përfshirë mbrojtjen nga skllavëria dhe diskriminimi racor.”<sup>21</sup> Gjykata ka deklaruar në rastin e *Timorit Lindor* se, një karakter të këtillë (*erga omnes*) ka edhe e drejta e popujve për vetëvendosje,<sup>22</sup> dhe këtë e ka riafirmuar në mendimin këshillëdhënës për *pasojat ligjore të ndërtimit të një muri në territoret e pushtuara palestineze*.<sup>23</sup> Në rastin e *aktiviteteve të armatosura në territorin e Kongos*, Gjykata ka thënë shprehimisht, për shembull, se norma për ndalimin e gjenocidit është një normë *jus cogens*.<sup>24</sup>

## 2. Detyrimet *erga omnes*

<sup>19</sup> *Shih* nenin 53 të Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve.

<sup>20</sup> Lidhur me marrëdhëniet ndërmjet normave *jus cogens* dhe detyrimeve *erga omnes*, *shih* CHRISTIAN TOMUSCHAT & JEAN-MARC THOUVENIN (EDS.), *THE FUNDAMENTAL RULES OF THE INTERNATIONAL LEGAL ORDER: JUS COGENS AND OBLIGATIONS ERGA OMNES* (2006).

<sup>21</sup> *Case Concerning the Barcelona Traction, Light and Power Co (Second Phase) (Belgium v. Spain)* 1970 I.C.J. 3, para. 34.

<sup>22</sup> *Case Concerning East Timor (Portugal v. Australia)*, 1995 I.C.J. 90, 102, para. 29.

<sup>23</sup> *Legal Consequences of the Construction of a Wall in the Occupied Palestinian Territory*, *supra* note 4, fq. 172, para. 88. Në këtë mendim këshillëdhënës, Gjykata ka gjetur se, “detyrimet *erga omnes* të shkelura nga Izraeli janë detyrimi për të respektuar të drejtën e popullit palestinez për vetëvendosje ...” *Id.* para. 155.

<sup>24</sup> *Case Concerning Armed Activities on the Territory of the Congo (New Application 2002) (Democratic Republic of the Congo v. Rwanda)*, 2006 I.C.J. 126, para. 64.

Koncepti i detyrimeve *erga omnes* është pranuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë në rastin *Barcelona Traction* (Belgjika kundër Spanjës).<sup>25</sup> Në këtë rast, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë thekson se një dallim duhet bërë ndërmjet detyrimeve të shteteve ndaj bashkësisë ndërkombëtare si të tërë (detyrimet *erga omnes*) dhe detyrimeve ndaj shteteve të tjera.<sup>26</sup> Në rastin e detyrimeve *erga omnes*, të gjitha shtetet kanë interes ligjor që detyrimi të respektohet.

### C. Përfundimi

Neni 53 i Konventës së Vjenës për të Drejtën e Traktateve paraqet një zhvillim të ri dhe të rëndësishëm për çështjen e hierarkisë. Me këtë rast, përmes kodifikimit të normave *jus cogens*, për herë të parë në historinë e të Drejtës Ndërkombëtare është krijuar një hierarki e normave, të paktën në kuptimin e përmbajtjes. Ndryshe, e drejta ndërkombëtare nuk njeh një hierarki formale sikurse e drejta vendëse. Sado e papërsosur, është e mundur që edhe në të drejtën ndërkombëtare sot të flitet për një hierarki materiale apo përmbajtësore. Për shembull, normat *jus cogens* kanë epërsi formale ndaj të gjitha normave të tjera të së drejtës ndërkombëtare.

Një moment tjetër i rëndësishëm për çështjen e përcaktimit të renditjes hierarkike të burimeve të së drejtës ndërkombëtare është neni 103 i Kartës së Kombeve të Bashkuara, që lexon si në vijim: “Nëse detyrimet e anëtarëve të Kombeve të Bashkuara, që rezultojnë nga kjo Kartë bien ndesh me ato që ata marrin përsipër në kuadër të marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare, atëherë detyrimet që rrjedhin nga Karta kanë përparësi.”<sup>27</sup> Duhet vërejtur, si fillim, se kjo dispozitë flet vetëm për marrëdhënien ndërmjet Kartës dhe marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare. Pra, ajo lë anash të drejtën ndërkombëtare zakonore. Sidoqoftë, në sferën e të drejtës ndërkombëtare kontraktuale, Karta e Kombeve të Bashkuara përcakton një regjim hierarkik, duke vendosur Kartën në pozicion superior në marrëdhënien e saj me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare.

---

<sup>25</sup> *Case Concerning the Barcelona Traction*, *supra* note 21.

<sup>26</sup> *Id.* para. 33.

<sup>27</sup> Karta e Kombeve të Bashkuara, *supra* note 5, neni 103.